



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:072583

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05580939

PKR.nr.108/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga Kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, gjyqtarët profesionistë Ilda Cucoviq Sahatqiu dhe Arben Mustafaj, me zyrtaren ligjore Zelfije Prekaj, në çështjen penale kundër të pandehurit D.M., *për shkak të veprës penale ri kualifikuar nga gjykata vrasje në tentativë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 12 par. 3 të KPRK-së dhe veprës penale ri kualifikuar lëndim i lehtë trupor në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe 12 par. 3 të KPRK-së*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP.I.nr. 84/21 dt. 09.08.2021, e kthyer në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit nën shenjën PAKR.nr. 258/23 dt. 21.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të përfunduar me datë 25.03.2024, në prezencë të prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit M. dhe mbrojtësit av.Gëzim Kollqaku, me datë 25.03.2024, bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 15.04.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D.M.**, i biri i dhe nënës e gjinisë, i lindur me dt. në fsh. K, ku edhe jeton, rr. “.....” nr. 60, i pa martuar, bujk, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, nr. personal, lëshuar nga MPB e R. së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 22.03.2021 deri me dt. 18.10.2021.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me dt. 22.03.2021 rreth orës 15:50, në sheshin në, duke vepruar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme ka tentuar ta privojë nga jeta Sh.N., në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve të mëparshme dhe të atë çastshme gjatë përleshjes fizike në të cilën ishin përfshirë në njërin anë të pandehurit R., Sh., I. dhe R. N. dhe në anën tjetër të pandehurit D.M., E.T., D.O. dhe R.M., e deri tek i cili konflikt kishte ardhur si rrjedhojë e një konflikti verbal paraprakë mes të pandehurit Sh.N. dhe N.N., për të cilin konflikt është njoftuar edhe policia nga ana e të pandehurit Sh., ku me të dal nga Stacioni Policor në Deçan, tek rreth rrotullimi nga vetura e vërejnë duke ecur në zebra N.N., dhe me të vërejtur të njëjtin, i pandehuri I. del nga

vetura, pas tij dalin edhe të tjerët dhe me hapa të shpejt nisen pas N.N., të cilin e ndjekin deri në brendi të restorant “.....”, ku N.N. arrin të mbyllet në tualet, gjersa i pandehuri I. i cili kishte një sëpatë në dorë, vërsulet në drejtim të tualetit, aty ndërhyjnë dëshmitari Xh. B., dhe arrin që t’ia heq sëpatën, e pasi arrijnë pjesëtarët e policisë në restorant, I. dhe të tjerët i largojnë nga restoranti derisa N.M. nga frika e rrezikut që i kanosej telefonin vëllain e tij D.M., i cili së basku me axhën e tij R.M. dhe të pandehurit E.T. dhe D.O., nisen për në ... me automjetin e tij tip “.....”, të cilin e ngiste i pandehuri D.M. dhe me të arritur përballë stacionit policor, ende pa dal nga vetura, i pandehuri I. N. së bashku me R., Sh., dhe R.N., të cilët tashmë kishin dal nga restoranti “.....”, vërejnë veturën e të pandehurit D., dhe për një moment i pandehuri I. hedhet mbi pjesën e parme të veturës duke plas edhe xhamin e parafangos dhe me shpejtësi kalon në anën e vozitësit e nxjerrin nga vetura, fillojnë të godasin me grusht dhe shqelma disa herë D.in, në pjesë të ndryshme të trupit, në kokë dhe në fytyrë derisa i pandehuri Ramiz gjatë përleshjes me brisk e godet një herë të pandehurin D. në pjesë e kofshës së majtë ku i shkakton plagë prerëse, të cilat janë konstatuar si dëmtime të lehta trupore, ashtu që për t’u mbrojtur nga sulmi i mëtejshëm, nxjerrë nga xhupi i tij një brisk me të cilin e godet Sh.N., dy herë në dy anët e kraharorit dhe atë në pjesën e shpatullës së djathtë një herë në pjesën e pasme të kofshës të këmbës së djathtë dhe një herë në pjesën e sipërme të dorës së djathtë duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore të cilat në momentin e shkaktimit kanë qenë të rrezikshme për jetën e të dëmtuarit Sh.N..

-Me çka ka kryer veprën penale vrasje e mbetur në tentativë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së.

II. Po të njëjtën kohë dhe po në të njëjtin vend për arsyt e lartcekura, i pandehuri D.M., duke vepruar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, me përdorim të mjetit të rrezikshëm i shkakton personit tjetër lëndim të lehtë trupor dhe atë për tu mbrojtur nga sulmi, të cekura si në pikën I të aktgjykimit, pasi nga xhupi nxjerrë një brisk me të njëjtin e godet I. N., dy herë në të dy anët e regjionit të krahut, në anën e majtë të shpinës duke i shkaktuar plagë shpuese-prerëse, duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- Me çka ka kryer vepër penale të ri kualifikuar lëndim i lehtë trupor ne tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe 12 par. 3 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 38, 39 par.1, 42, 43, 69 par.3, pika 3.1, 3.4,3.6 dhe 3.7, 70 par.3, pika 3.10, 71 par.1, pika 1.1 dhe 1.3, 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3, 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe 12 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 364, 365, 449 par.1 dhe 2, pika 2.6 të KPPRK-së, të njëjtin e:

G J Y K O N

Më dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj dhe 28 ditë, duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 22.03.2021 deri me dt. 18.10.2021, dhe

Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) €, dënime të cilat do t ekzekutohen pesëmbëdhjete (15) ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform 276 par.1 lidhur me par. 2 pika 2.1 të KPPRK-së,

KONFISKOHET një brisk i sekuestruar, sipas listës së dëshmive me numër të rastit 2021-DC-81 dt. 22.03.2021.

URDHËROHET që brisku i lartcekur, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Me datë 09.08.2021, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/I.nr.84/21, kundër të pandehurve D.M., për shkak të veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së, E.T. për shkak të 2 veprave lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-s, Ramiz N. për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së, D.O. për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, R. N. për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, R.M. për shkak të veprës penale të Sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, Shqipërim N. për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, I. N. për shkak të veprës penale sulmit nga neni 184 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate të dt.13.03.2023, gjykata të pandehurit e cekur më lartë i ka shpallë fajtor, si në aktgjykim në fjalë.

Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas aktvendimit PAKR.nr. 258/23 dt. 21.12.2023, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda, dhe çështja është kthyer në rigjykim vetëm sa i përket të akuzuarit D.M., për vepër penale vrasje e mbetur në tentativë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 172 lidhur me nenin 28 të ri kualifikuar dhe 12 par. 3 të KPRK-së dhe lëndim i lehtë trupor në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe 12 par. 3 të KPRK-së të ri kualifikuar.

Me datë 19.03.2024, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Para se të lexohet aktakuza, prokurorja e shtetit, ka vërejtur se nuk ka pas ankesë në raport me këtë të pandehur për ri cilësim të veprave penale për të cilat është shpall fajtor, andaj dhe mbetet pranë një cilësimi të tillë.

Pas leximit të aktakuzës, për veprat penale të ri cilësuara, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, konform nenit 242 par 1 pika 1.1-1.4 të KPPRK-së.

I pandehuri pas njoftimit me të drejtat e tij, ka deklaruar se nuk e pranoj fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me administrimin e provave personale dhe materiale.

Prokuroja e shtetit para se të vazhdohet me fjalën përfundimtare ka bërë përmirësimin e përshkrimit faktik të veprës penale si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh vërejtjet Gjykata e Apelit sipas Aktgjykimit PAKR.nr. 258/23 dt. 05.12.2023, ndërsa sa i përket pikës II të aktakuzës po ashtu në raport me të pandehurin D., ka mbetur ashtu siç është përshkruar në aktgjykimin e dt. 13.03.2023.

I akuzuari D.M. pas përmirësimit të dispozitivit nga ana e prokurores së shtetit, në konsultim me mbrojtësin e tij, ka kërkuar dhe njëherë ti ipet mundësia e deklarimit fajtor, andaj dhe ka deklaruar se e pranon fajësinë për dy veprat penale të ri cilësuara, që i vihen në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurorja e Shtetit dhe deklarimit të mbrojtësit, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, e bindur se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitës së nenit 242 par 1 pika 1.1-1.4 të KPPRK-së, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes dhe shkresave të lëndës siç janë: Foto e briskut të sekuestruar nga i pandehuri D.M. bashkangjitura kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.23.03.2021, Fotot e veturës së të pandehurit D.M. në vendin e ngjarjes bashkangjitura kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.23.03.2021, Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i pandehuri D.M., briskut nën numër rasti 2021-DC-81 dt.22.03.2021, Foto albumin mbi ekzaminimin e veturës së të pandehurit D.M. me nr.rasti 2021-DC-81 dhe numër dosje të Forenzikës 2021-DTK-17 dt.22.03.2021 sipas plotësimit të kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.31.03.2021, Raporti i Ekzaminimit të veturës sipas plotësimit të kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.31.03.2021, Foto Albumi nga vendi i ngjarjes sipas plotësimit të kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.31.03.2021 nën numër dosje të forenzikës 2021-DTK-17 dt.22.03.2021, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes sipas plotësimit të kallëzimit penal nën numër 2021-DC-81 dt.31.03.2021 nën nr. Dosje NJKTK- 201-DTK-17, Shënimi zyrtar përpiluar nga hetuesi policor J.J. nën nr. rasti 2021-DC-81 dt.31.03.2021 lidhur me Analizën e Video incizimit të pranuar nga qytetari anonim, Shënimi zyrtar përpiluar nga hetuesi policor J.J. nën nr. rasti 2021-DC-81 dt.31.03.2021 lidhur me Analizën e Video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë që janë të vendosura në qendër të qytetit në Deçan, Shënimi zyrtar përpiluar nga hetuesi policor J.J. nën nr. rasti 2021-DC-81 dt.31.03.2021 lidhur me Analizën e Video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë që janë të vendosura në restauronit, Ekspertiza mjeko ligjore me nr. reference Pe-233/21 dt.04.06.2021 përpiluar nga Eksperti mjeko ligjor Dr. Ditor Haliti lidhur me natyrën e lëndimeve të pësuar tek Shqipërim N. dhe D.M., Vërtetim Nënshkrimi përpiluar

nga Noteri Haxhë Qorraj nën numër LRP.Nr.4170/2021 dt.09.07.2021 mbi marrëveshjen mbi pajtimin familjar mes familjes N. dhe familjeve M., T. dhe O., Video incizimet nga kamerat e sigurisë dhe atë video incizimet e siguruar nga Restoranti, Sheshi, Videoincizimi nga qytetari anonim, një CD me video incizim nga vendi i ngjarjes e dorëzuar nga mbrojtësi i të pandehurit D.M., Gëzim Kollqaku, e nxjerrë sipas mbrojtësit nga kalimtarët e rastit.

Në bazë të pranimin të plotë të fajësisë të të pandehurit, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale *vrasje e mbetur në tentativë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme* nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së dhe *lëndim i lehtë trupor në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme* nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe 12 par. 3 të KPRK-së.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve, të cilët kanë heq dorë nga caktimi i seancës për dënim.

Prokurorja e Shtetit Lumturije Vuçetaj, në fjalën e saj përfundimtare në mes tjerash ka thënë se, pas administrimit të provave në ri gjykim dhe në gjykimin e mëparshëm po ashtu në përputhje me rekomandimet e Gjykatës së Apelit, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e përmirësuar dhe në përputhje me dispozitivin si në pikë II të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, po ashtu pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprat penale të përshkruara si më lartë. Ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në faqe 2 dhe 3 të fjalës përfundimtare, po ashtu dhe evidencën penale të dt. 22.03.2024, të siguruar nga KGJK ka të bëjë lidhur me të kaluarën kriminale të pandehurit D..

Mbrojtësi i të pandehurit D.M., av.Gëzim Kollqaku, në fjalën përfundimtare në mes tjerash ka thënë se meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë për dy vepra penale që i vihen në barrë, ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim si rrethanat lehtësuese të merr moshën e re, rrethanat mbi të cilat ka ndodhur ngjarja ku i njëjti ka qenë vet i dëmtuar, pajtimin mes dy familjeve si dhe rrethanat se që nga viti 2021 e deri më tani nuk ka ra ndesh me ligjin. I ka propozuar gjykatës që ti ipet një dënim aq sa i njëjti ka qenë në paraburgim.

I pandehuri D.M., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata për të pandehurin D.M., mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethanat lehtësuese në raport me dy veprat penale, bazuar në nenin 69 par.2 dhe 3 pika 3.1, 3.4, 3.5 dhe 3.7 të KPRK-së, mori shkallën e përgjegjësisë penale, pasi i njëjti ishte i sulmuar paraprakisht, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, përkatësisht i njëjti veprimet inkriminuese i kishte ndërmarrë me qëllim të zbrapsje së sulmit, e cila ka rezultuar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata e mori moshën e re të të njëjtit, gjendje e dobët ekonomike, pranimin e fajësisë, e po ashtu si rrethanë lehtësuese ka marrë dhe faktin se pandehuri M., ka arritur marrëveshje për pajtim për konfliktin çështje gjykimi dhe se nga kryerja e kësaj vepre penale sjellja e tij ka qenë e mirë, andaj në referim të paragrafit 4 të nenit 12 të KPRK-së, e cila parasheh *se kryesi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryesi tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi*, si dhe nenit 71 par 1 pika

1.1 të KPRK-së, e cila përcakton se dënimi mund të zbutet kur e parasheh ligji, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa si rrethanë rënduese mori se i njëjti më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, andaj gjykata erdhi në përfundim se të njëjtit duhet zbut dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pas parasysh rrethanat lehtësuese të cekura më lartë, me bindje se dënimi i shqiptuar do të jetë i mjaftueshëm në arritje të qëllimi të dënimit ashtu siç përcaktohet dhe me dispozitivën e nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata, ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin u morr konform nenit 276 par.1 lidhur me par. 2 pika 2.1 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e paraburgimit në dënim, u morr në aplikim të nenit 79 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.108/23

Zyrtare ligjore
Zelfije Prekaj

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.